



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
SP-027

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR
MË 16, 17, 18, 26 PRILL, 31 MAJ, 4, 5, 8 DHE 28 QERSHOR 2018

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti, Kujtim Shala dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2018.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Avdullah Hoti, Albin Kurti, Driton Çausi, Ganimete Musliu, Milaim Zeka, Emilija Rexhepi, Lumir Abdixhiku dhe Glauk Konjufca, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Mimoza Kusari-Lila i parashtrroi pyetje ministres së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, në lidhje me ndarjet buxhetore për vitin 2018 për projektin e impiantit të ujërave të zeza në Gjakovë.

Ministrja Albena Reshitaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Shqipe Pantina i parashtrroi pyetje ministrit të Administratës Publike, Mahir Jagxhilar, në lidhje me pjesëmarrjen e zyrtarëve të shërbimit civil në trajnimet e organizuara me pagesë nga organizata të ndryshme.

Ministri Mahir Jagxhilar iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Adem Mikullovc i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me planifikimet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për hartim të një ligji për pensionet e artistëve dhe kategorive të tjera që kanë dhënë kontribut të veçantë për vendin.

Ministri Skender Reçica iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Arbër Rexhaj i parashtrroi pyetje ministres së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, në lidhje me deponitë ilegale të mbeturinave dhe investimin në ujërat e zeza në Landovicë të komunës së Prizrenit.

Ministrja Albena Reshitaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi i parashtrroi pyetje ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, në lidhje me një shkresë të ministrit Berisha për pezullimin e Vendimit të Qeverisë për ndërtimin e Kampusit Universitar në Gjilan në parcelën e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ministri Rrustem Berisha iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Mimoza Kusari-Lila i parashtrroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në lidhje me zvogëlimin e buxhetit të paraparë për vitin 2018 për projektin e fushave të tenisit në Gjakovë.

Ministri Kujtim Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Zafir Berisha i parashtrroi pyetje ministres së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, në lidhje me masat e ndërmarra nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për ndalimin e projektit “Lugina e Diellit” në Zveçan.

Ministrja Albena Reshitaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, lidhur me nivelin e zbatimit të Ligjit për arsimin parauniversitar në shkollat me mësim në gjuhën serbe.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Arbërie Nagavci i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, lidhur me anulimin e konkursit për “Shkencëtar i vitit 2017” dhe “Shkencëtari i ri i vitit 2017”.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Shemsi Syla i parashtrroi pyetje ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, në lidhje me armatimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të lejuar me ligj.

Ministri Rustem Berisha iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Besa Baftiu i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me inspektimet dhe gjobot e shqiptuara nga Inspektorati i Punës për rastet e lëndimeve dhe rastet e vdekjeve të punëtorëve në vendet e punës.

Ministri Skender Reçica iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Slobodan Petroviq i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me hetimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës për rastin e vrasjes së Oliver Ivanoviqit.

Kryeministri Ramush Haradinaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, lidhur me planifikimet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për ndërtimin e çerdhes publike në Prizren.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj i parashtrroi pyetje ministres së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, në lidhje planifikimet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për fillimin e punimeve për projektin e ndërrimit të gypave të ujësjellësit në rrugët “Janina” dhe “Nënë Tereza” në Prizren.

Ministrja Albena Reshitaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

* * *

Në vazhdim, kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Ismajl Kurteshi, propozoi që rendi i ditës i seancës plenare të plotësohet edhe me një pikë: Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe për shmangien nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e kësaj pike.

Kryesuesi kërkoi deklarimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e lartcekur.

Në lidhje me propozimin e lartcekur diskutuan: Avdullah Hoti në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Ahmet Isufi në emër të GP të AAK-së; Haxhi Shala, në emër të GP NISMA dhe Albert Kinolli në emër të GP 6+, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim propozimin për plotësimin e rendit të ditës si dhe shmangien nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit..

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 60,
Kundër -----1,
Abstenime -----1.

Kuvendi me shumicë votash vendosi plotësimin e rendit të ditës me pikën: Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe për shqyrtimin e Propozim-vendimit të lartcekur me shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

* * *

Më pas, kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti, propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me një pikë: Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të 6 (gjashtë) shtetasve turq, sipas rekomandimeve të Kuvendit të miratuara në seancën plenare më 4 prill 2018, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi kërkoi deklarimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e lartcekur.

Në lidhje me propozimin e lartcekur diskutuan: Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Ahmet Isufi në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP NISMA dhe Albert Kinolli në emër të GP 6+, si dhe Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe Driton Selmanaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në vazhdim, në lidhje me këtë çështje, kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti, propozoi që Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit ta përgatitë opinionin ligjor të kërkuar nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2018, lidhur me kryesimin e Komisionit Hetimor Parlamentar.

Pastaj, kryesuesi e dha një pauzë.

Pas pauzës, kryetarja e Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Albulena Haxhiu, i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, gjatë pauzës së seancës plenare ka mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme për shqyrtimin e përfundimit të Kryesisë së Kuvendit lidhur me kryesimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, që ka të bëjë me depërtimin e gjashtë shtetasve turq dhe Kuvendit ia paraqiti rekomandimet e komisionit lidhur me

kryesimin e Komisionit Hetimor Parlamentar. Diskutimi i plotë i znj. Haxhiu është i dhënë në transkript.

Lidhur me rekomandimet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, për kryesimin e Komisionit Hetimor Parlamentar diskutuan: Hajdar Beqa, zëvendëskryetar i parë i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP NISMA dhe Avdullah Hoti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim propozimin e kryetarit të GP të LDK-së, Avdullah Hoti, për plotësimin e rendit të ditës, me pikën: Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të 6 (gjashtë) shtetasve turq

Pas diskutimeve kryesuesi tha se në mungesë të kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij propozimi shtyhet.

Votimi i propozimit të lartcekur është bërë më 17 prill 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 66,
Kundër -----0,
Abstenime -----5.

Kuvendi me shumicë votash vendosi plotësimin e rendit të ditës së seancës plenare me pikën: Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq, më 29 mars 2018.

Në vazhdimin e kësaj seance plenare më 26 prill 2018 është diskutuar përsëri çështja e formimit të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq.

Pas diskutimeve, kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti, e tërhoqi propozimin për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq. Diskutimi i z. Hoti lidhur me arsyetimin për tërheqjen e këtij propozimi është dhënë në transkript.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave të Kuvendit të mbajtura më 8, 9, 22, 23, 28 shkurt; 1, 2, 7, 8, 13, 14, 15, 16, 20, 21, 23, 30 mars dhe 4 prill 2018.

Deputeti Sami Kurteshi pati vërejtje në procesverbalin e seancës së jashtëzakonshme, të mbajtur më 21 mars 2018, me arsyetimin se nuk janë pasqyruar vendimet e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit për përjashtimin e disa deputetëve që kishin hedhur gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare.

Sqarim: Vendimet e Kryesisë së Kuvendit janë pasqyruar në procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit të datës 21 mars 2018.

Në procesverbal nga një mbledhjeje evidencohet vetëm ngjarja që ka ndodhur në atë mbledhje dhe jo ndodhitë që janë zhvilluar në trupat e tjerë të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij

Pastaj, kryesuesi e ftoi ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ta paraqesë dhe ta arsyetojë Propozim-vendimin e Qeverisë.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë atë.

Lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë diskutuan: Ismajl Kurteshi, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së; Arbërie Nagavci, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP NISMA, Memli Krasniqi, Daut Haradinaj dhe Emilija Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Më pas, kryesuesi e hodhi dy herë në votim Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, mirëpo nuk pati kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Votimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë është bërë më 17 prill 2018.

Para votimit, kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrës, Ismajl Kurteshi, para deputetëve i paraqiti sqarimet lidhur me

mandatin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë. Diskutimi i z. Kurteshi është dhënë i plotë në transkript.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----66,
Kundër-----5,
Abstenime-----0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Për ratifikimin e 9 (nëntë) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit

I. Ratifikohen anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit, si në vijim:

1. Prof. Ass. Dr. Vjollca Krasniqi,
2. Prof. Ass. Dr. Arta Jakupi,
3. Dr.Sc. Spec. Rozafa Koliqi-Lila,
4. Prof. Dr. Magdalena Ziolo,
5. Prof. Dr. Gazmend Luboteni,
6. Prof. Dr. Herbert K. Amato,
7. Prof. Dr. Xhavit Rexha,
8. Prof. Msc. Jeffery Butel dhe
9. Prof. Ass. Dr. Dukagjin Zeka.

II. Mandati i anëtarëve të ratifikuar të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit, sipas pikës (I) të këtij vendimi, është pesë (5) vjeçar.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-061 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Pastaj, kryesuesi e ftoi ministrin e Drejtësisë, z. Abelard Tahiri, ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Drejtësisë, z. Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë mbi transferimin e personave të dënuar diskutuan: Albulena Haxhiu, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit; Driton Selmanaj, në emër të GP të LDK-së; Hajdar Beqa, në emër të GP të PDK-së; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Shqipe Pantina, në emër të GP Deputetët e Pavarur dhe Shkumbin Demaliaj, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në vazhdim kryesuesi tha se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Votimi i Projektligjit nr. 06/L-061 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë mbi transferimin e personave të dënuar është bërë më 4 qershor 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----84,
Kundër----- 0,
Abstenime-----0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji Nr. 06/L-061 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë mbi transferimin e personave të dënuar.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjykatat

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Pastaj, kryesuesi e ftoi ministrin e Drejtësisë, z. Abelard Tahiri, ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Drejtësisë, z. Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë.

Lidhur me Projektligjin për gjykatat diskutuan: Albulena Haxhiu në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të LVV-së; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Hajdar Beqa, në emër të GP të PDK-së; Shqipe Pantina, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Shkumbin Demaliaj, në emër të GP të AAK-së, Sami Kurteshi, Arbërie Nagavci, Drita Millaku, Salih Zyba, Fitore Pacolli, Besa Gaxherri dhe Milaim Zeka, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryetari tha se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Votimi në parim i Projektligjit për gjykatat është bërë më 17 prill 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----48,
Kundër-----26,
Abstenime-----2.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-054 për gjykatat.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Pastaj, kryesuesi e ftoi ministrin e Drejtësisë, z. Abelard Tahiri, ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Drejtësisë, z. Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë.

Lidhur me Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës diskutuan: Albulena Haxhiu në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Hajdar Beqa, në emër të GP të PDK-së; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Shqipe Pantina, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP NISMA, Fitore Pacolli dhe Drita Millaku, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari tha se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Votimi në parim i Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës është bërë më 17 prill 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----74,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 1.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Pastaj, kryesuesi e ftoi ministrin e Drejtësisë, z. Abelard Tahiri, ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Drejtësisë, z. Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë.

Lidhur me Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës diskutuan: Albulena Haxhiu në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të LVV-së; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së; Shqipe Pantina, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Shkumbin Demaliaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP NISMA, Sami Kurteshi dhe Fitore Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Votimi në parim i Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës është bërë më 17 prill 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----74,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtaritë hidrometeorologjike

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Pastaj, kryesuesi e ftoi ministren e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor, znj. Albena Reshitaj, ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, znj. Reshitaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë.

Lidhur me Projektligjin për veprimtaritë hidrometeorologjike diskutuan: Besa Gaxherri, në emër të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor dhe në emër të GP të LDK-së; Ganimete Musliu, në emër të GP të PDK-së; Arbërie Nagavci, në emër të GP të LVV-së; Salih Salihu, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP NISMA dhe Lutfi Zharku, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Votimi në parim i Projektligjit për veprimtaritë hidrometeorologjike është bërë më 17 prill 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----64,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 8.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike.

2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Pastaj, kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Në emër të Qeverisë, ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës diskutuan: Nait Hasani, në emër të Komisionit Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe në emër të GP të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Valon Ramadani, në emër të GP të LVV-së; Shqipe Pantina, në emër të GP Deputetët e Pavarur; dhe Rasim Selmanaj, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës është bërë më 17 prill 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----56,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 18.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Pastaj, kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, që në cilësinë e propozuesit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Zëvendëskryetarja e Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Shqipe Pantina, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë.

Lidhur me Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës diskutuan: Shqipe Pantina, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe në emër të GP Deputetët e Pavarur; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Nait Hasani, në emër të GP të PDK-së; Valon Ramadani, në emër të GP të LVV-së; Rasim Selmanaj, në emër të GP të AAK-së dhe Bilall Sherifi, në emër të GP NISMA, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Votimi në parim i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është bërë më 17 prill 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----56,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 18.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës.
2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

* * *

E martë, më 17 prill 2018
Vazhdimi i seancës plenare

Vazhdimin e seancës plenare e kryesoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Në vazhdimin e kësaj seance plenare u votua për plotësimin e rendit të ditës me pikën Ratifikimi i nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe u ratifikuan anëtarët e këtij këshilli, po ashtu u miratuan në parim edhe gjashtë projektligje. Rezultatet e këtyre votimeve janë pasqyruar së bashku me shqyrtimet e pikave përkatëse.

Pas votimeve të lartpërmendura, kryesuesi procedoi me pikat, si në vijim:

12. Shqyrtimi i raportit të operatorit të sistemit, transmisionit dhe tregut-KOSTT sh.a për vitin 2016

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar këtë raport dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Lidhur raportin e operatorit të sistemit, transmisionit dhe tregut-KOSTT sh.a për vitin 2016 diskutuan: Sala Shala-Berisha, në emër të Komisionit Funkcional dhe në emër të GP të PDK-së; Hykmete Bajrami, në emër të GP të LDK-së; Albin Kurti, në emër të GP të LVV-së; Visar Ymeri, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Milaim Zeka, në emër të GP NISMA, Naser Rugova, Elmi Reçica dhe Islam Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Më pas, kryesuesi e hodhi në votim raportin e operatorit të sistemit, transmisionit dhe tregut-KOSTT sh.a për vitin 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----47,
Kundër----- 24,
Abstenime-----3.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i operatorit të sistemit, transmisionit dhe tregut-KOSTT sh.a për vitin 2016, me rekomandimet e Komisionit Funkcional.

13. Përzgjedhja e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryesuesi deklaroi se në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për në një seancë tjetër.

14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë (6) anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar këtë propozim-vendim të Qeverisë dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë (6) anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit diskutuan; Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së dhe Dardan Sejdiu në emër të GP Deputetët e Pavarur, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe procedimi i votimit të këtij propozim-vendimi shtyhet.

Votimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë (6) anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit është bërë më 31 maj 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----46,
Kundër-----18,
Abstenime-----0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e gjashtë (6) anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

I. Emërohen anëtarët e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si në vijim:

1. Hasime Mazreku,
2. Skender Komoni,
3. Ranko Gjokiq,
4. Qemajl Behrami,
5. Bekim Selimaj dhe
6. Avni Ajdini.

II. Mandati i anëtarëve të emëruar të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, sipas pikës (I) të këtij vendimi, është katër (4) vjeçar.

Shënim: Pika 15 dhe e 16 janë, me vendim të Kuvendit, me votim të fshehtë janë proceduar përnjëherë.

15. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës dhe

16. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor i ka rekomanduar Kuvendit zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, prej dy kandidatëve të propozuar.

Gjithashtu, Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave i ka rekomanduar Kuvendit zgjedhjen e tre anëtarëve nga kandidatët e propozuar.

Kryesuesi propozoi që votimi i fshehtë të bëhet përnjëherë me kandidatët për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës dhe zgjedhjen e tre (3) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Kuvendi e miratoi propozimin e kryesuesit.

Kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues, për të zhvilluar procedurat e votimit të fshehtë.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e zgjodhi Komisionin votues në këtë përbërje:

Fidan Rekaliu, GP LDK,
Evgjeni Thaçi, GP PDK,
Valon Ramadani, GP LVV,
Salih Salihu, GP Deputetët e Pavarur,
Rasim Selmanaj, GP AAK,
Jelena Bontić, GP Lista serbe,
Enver Hoti, GP Nisma dhe
Bahrim Shabani, GP 6+.

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit votues që të fillojnë procedurat e votimit të fshehtë për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës dhe zgjedhjen e tre (3) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave, si dhe i ftoi deputetët një nga një që të votojnë.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues, rezultatin e votimit për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës e paraqiti deputeti Salih Salihu.

Rezultati i votimit ishte:

Në votim kanë marrë pjesë 92 deputetë:

- Të pavlefshme janë 27 votime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin:

1. Arbër Hadri ----- 23 vota,
2. Driton Mulaj ----- 42 vota.

Kryesuesi konstatoi se asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk i fitoi votat e nevojshme për t'u zgjedhur drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës. Konkursi për këtë pozitë duhet të përsëritet.

Në vazhdim, në emër të Komisionit votues, rezultatin e votimit për zgjedhjen e tre (3) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave e paraqiti deputetja Evgjëni Thaçi- Dragusha.

Rezultati i votimit ishte:

Në votim kanë marrë pjesë 92 deputetë:
- Të pavlefshme janë 27 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar ishin:

1. Violeta Hyseni-Kelmendi ---- 54 vota dhe
2. Shqipe Breznica ----- 28 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komunitetit serb ishin:

1. Maja Slaviq ----- 58 vota dhe
2. Nenad Janiqeviq -----3 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuara për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komuniteteve të tjera ishin:

1. Birol Urcan ----- 36 vota dhe
2. Mejdin Saliji ----- 25 vota.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Znj. Violeta Hyseni-Kelmendi zgjidhet anëtare e Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar.
2. Znj. Maja Slaviq zgjidhet anëtare e Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komunitetit serb.
3. Kandidatët e propozuar Birol Urcan dhe Mejdin Saliji, për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë, asnjëri nuk i morën votat e nevojshme për t'u zgjedhur anëtar i këtij komisioni.

4. Të përsëritet konkursi për zgjedhjen e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë.

5. Mandati i të zgjedhurave në pikën 1 dhe 2 caktohet me short, sipas nenit 13 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave.

17. Interpelanca e ministrit të Shëndetësisë, z. Uran Ismajli, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje në lidhje me sistemin informativ shëndetësor dhe sigurimet shëndetësore publike dhe private në Republikën e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismajli, lidhur me sistemin informativ shëndetësor dhe sigurimet shëndetësore publike dhe private në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputetja Fatmire Kollçaku, në emër të Grupit Parlamentar të LVV-së, e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për interpelancë me ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismajli, lidhur me sistemin informativ shëndetësor dhe sigurimet shëndetësore publike dhe private në Republikën e Kosovës. Diskutimi i plotë i saj është dhënë në transkript.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Shëndetësisë, z. Uran Ismaili, që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me këtë çështje.

Ministri i Shëndetësisë, z. Ismaili, e paraqiti dhe e arsyetoi qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjet e ngritura në interpelancë. Diskutimi i plotë i ministrit Ismaili është dhënë në transkript.

Për interpelancën e ministrit të Shëndetësisë diskutuan deputetët: Haxhi Avdyli, në emër të GP të LDK-së; Flora Brovina, në emër të GP të PDK-së; Xhelal Sveçla, në emër të GP të LVV-së; Besa Baftiu, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së; Enver Hoti, në emër të GP NISMA-s, Milaim Zeka, Muharrem Nitaj, Naser Rugova, Fatmir Xhelili, Sami Kurteshi, Dardan Sejdiu, Emilija Rexhepi, Imet Rrahmani, Blerim Kuçi, Salih Zyba, Armend Zemaj dhe Elmi Reçica, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Në fund, ministri Uran Ismajli dha sqarime shtesë lidhur me interpelancën e zhvilluar.

Pas këtyre diskutimeve, deputetja Fatmire Kollçaku, në emër të propozuesit të interpelancës e lexoi mocionin prej gjashtë pikash.

Pastaj, kryetari tha se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe procedimi i votimit të rekomandimeve shtyhet.

Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e zhvilluar në lidhje me sistemin informativ shëndetësor dhe sigurimet shëndetësore publike dhe private në Republikën e Kosovës është bërë më 26 prill 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----74,
Kundër-----2,
Abstenime-----2.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto:

R E K O M A N D I M E

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të fillojë me funksionalizimin dhe shtrirjen e plotë të Sistemit Informativ Shëndetësor dhe të bëjë publik kalendarin e aktiviteteve.
2. Qeveria e Kosovës të implementojë 22 masat e rekomanduara nga raporti i Auditorit të Përgjithshëm “Efikasiteti dhe efektiviteti në implementimin e sistemit informativ unik të integruar shëndetësor”, dhjetor 2017.
3. Qeveria e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Oda e Profesionistëve Shëndetësorë dhe SHSKUK të hartojë dhe përgatisë parakushtet për Sistemin Informativ Shëndetësor ku përfshihen:
 - a. Lista e shërbimeve në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor në Kosovë në institucionet publike e ato private.
 - b. Kontrolli, e më pas licencimi i të gjithë profesionistëve shëndetësorë që i plotësojnë kushtet, në sektorin publik dhe atë privat.
 - c. Krijimi i regjistrit shtetëror të punonjësve shëndetësorë në të gjitha institucionet publike dhe private.
 - d. Ndërtimi i sistemit të referimit të pacientëve.
 - e. Hartimi dhe zyrtarizmi i Udhërrëfyesve klinikë.
 - f. Regjistri shtetëror i barnave.
4. Kuvendi i Kosovës i kërkon Bankës Qendrore të Kosovës të paraqesë jo më vonë se 60 ditë pune raport të detajuar mbi financat dhe operacionet e kompanive të sigurimit të licencuara, të cilat ofrojnë dhe sigurimet private shëndetësore.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në raportin e performansës së Auditorit të Përgjithshëm, të adresojë në institucionet e drejtësisë rastet e shkeljeve dhe të dëmit financiar nga mosimplementimi në kohë i projektit për Sistemin Informativ Shëndetësor.

* * *

Në vazhdim kryetari kërkoi nga grupet parlamentare të deklarohen lidhur me vazhdimin e seancës me pikat e mbetura ose të ndërpriten punimet për të vazhduar të nesërmen.

Lidhur me këtë çështje diskutuan deputetët: Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Salih Salihu, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së dhe Enver Hoti, në emër të GP NISMA-s, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Pas këtyre deklarimeve, kryetari i ndërpreu punimet e kësaj seance në orën 21:15, për të vazhduar të nesërmen, më 18 prill 2018, në orën 11:00.

* * *

E mërkurë, më 18 prill 2018

Vazhdimi i seancës plenare

Vazhdimin e seancës plenare e kryesoi Xhavit Haliti, nënkryetari i Kuvendit, i ndihmuar nga Mufera Shinik, nënkryetare e Kuvendit.

Kryesuesi procedoi me pikat e rendit të ditës si në vijim:

18. Debat parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me të gjeturat e raportit të Komisionit shtetëror për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror

Me kërkesën e propozuesit, kjo pikë u hoq nga rendi i ditës së seancës plenare.

19. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetëve Ganimete Musliu, Salih Salihu dhe Driton Çausi, në lidhje me skandalin e mishit të prishur të ardhur nga Belgjika, si dhe cilësinë dhe sigurinë e ushqimit në Kosovë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit të mbajtur më 11 prill 2018, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të PDK-së dhe Deputetëve të Pavarur, është vendosur që të mbahet vetëm një debat parlamentar nga dy kërkesat për debate lidhur me skandalin e mishit të prishur të ardhur nga Belgjika, si dhe cilësinë e sigurisë së ushqimit në Kosovë.

Kryesuesi e ftoi deputeten Ganimete Musliu, në cilësinë e propozueses, ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati.

Deputetja Ganimete Musliu në cilësinë e propozueses e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për debat parlamentar lidhur me skandalin e mishit të prishur të ardhur nga Belgjika, si dhe cilësinë dhe sigurinë e ushqimit në Kosovë. Diskutimi i plotë i deputetes Ganimete Musliu është dhënë në transkript.

Më pas kryesuesi e ftoi edhe deputetin Salih Salihu, në emër të propozuesit, të paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati.

Deputeti Salih Salihu, si njeri prej propozuesve, e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për debat parlamentar lidhur me skandalin e mishit të prishur të ardhur nga Belgjika, si dhe cilësinë dhe sigurinë e ushqimit në Kosovë. Diskutimi i plotë i deputetit Salih Salihu është dhënë në transkript.

Në lidhje me debatin parlamentar për skandalin e mishit të prishur të ardhur nga Belgjika, si dhe cilësinë dhe sigurinë e ushqimit në Kosovë, diskutuan deputetët: Besa Gaxheri, në emër të GP të LDK-së; Andin Hoti, në emër të GP të PDK-së; Arbër Rexhaj, në emër të GP të LVV-së; Salih Salihu, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Daut Haradinaj, në emër të GP të AAK-së; Zafir Berisha, në emër të GP Nisma; Duda Balje, në emër të GP 6+, Ismajl Kurteshi, Imet Rrahmani, Luljeta Veselaj-Gutaj, Adem Mikullovc, Driton Çausi, Time Kadrijaj, Milaim Zeka, Mimoza Kusari-Lila, nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, Armend Zemaj, Fatmire Kollçaku, Memli Krasniqi, Emilija Rexhepi, Hajdar Beqa, Albulena Haxhiu, Shqipe Pantina, Blerim Kuçi, Arben Gashi, Bekim Haxhiu, Xhelal Sveçla, Naser Rugova, Nezir Çoçaj, Albin Kurti, Mërgim Lushtaku dhe Bilall Sherifi, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi tha se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe procedimi i votimit të rekomandimeve shtyhet.

Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me skandalin e mishit të prishur të ardhur nga Belgjika, si dhe cilësinë dhe sigurinë e ushqimit në Kosovë është bërë më 26 prill 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----76,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kuvendi me shumicë votash miratoi këto:

REKOMANDIME

1. Kryeministri të marrë masa adekuate ndaj përgjegjësve - Bordit dhe menaxhmentit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.
2. Organet e drejtësisë të fillojnë menjëherë hetimet ndaj institucioneve përgjegjëse publike dhe subjekteve private që sjellin në treg produkte të dyshimta.
3. Të bëhet mbështetje më e madhe buxhetore për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, për konsolidimin e saj me pajisje laboratorike, pajisjen e inspektorëve me kamera personale, ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe shtimin e stafit me inspektorë.

4. Në funksion të rritjes së transparencës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë të pasqyrojnë të gjitha të dhënat e veprimtarisë së inspektorëve në baza ditore në web faqen e tyre.
5. Të rishqyrtohet legjislacioni përkatës që saktëson periudhat kohore minimale, para skadimit të afatit të përdorimit të produkteve ushqimore që importohen në Republikën e Kosovës.
6. Të rritet mbështetja financiare për masat mbështetëse të programit për zhvillim rural që rrit prodhimin vendor.

20. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, e mbështetur edhe nga 11 deputetë nënshkruar, në lidhje me korrupsionin si kriter për liberalizimin e vizave

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se deputetja Shqipe Pantina, e mbështetur nga 11 deputetë nënshkruar, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me korrupsionin, si kriter për liberalizimin e vizave.

Pastaj, ai e ftoi deputeten Shqipe Pantina që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjet për të cilat është kërkuar debati parlamentar.

Deputetja Shqipe Pantina, në cilësinë e propozueses, e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për debat parlamentar lidhur me korrupsionin si kriter për liberalizimin e vizave. Diskutimi i plotë i deputetes Shqipe Pantina është dhënë në transkript.

Në lidhje me debatin parlamentar për korrupsionin si kriter për liberalizimin e vizave diskutuan deputetët: Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së; Shqipe Pantina, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së; Milaim Zeka, në emër të GP NISMA, Avdullah Hoti, Ahmet Isufi, Blerta Deliu-Kodra, Drita Millaku, Dardan Molliqaj, Ismajl Kurteshi, Sami Kurteshi dhe ministri Abelard Tahiri, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe procedimi i votimit i Propozim-rezolutës shtyhet.

Votimi i rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me korrupsionin si kriter për liberalizimin e vizave është më 31 maj 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----70,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kuvendi me shumicë votash miratoi këtë:

REZOLUTË

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon që të rritet buxheti dhe të ngrihen kapacitetet profesionale për sektorin e drejtësisë (Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor.
2. Kërkon nga organet e drejtësisë, Prokuroria dhe Gjyqësori, që të jenë më efikase në zgjidhjen e rasteve që ndërlidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin.
3. Kërkon nga Qeveria hartimin dhe procedimin në Kuvend brenda këtij viti kalendarik të projektligjeve që ndërlidhen me forcimin e masave në luftë kundër korrupsionit.
4. Kërkon nga Qeveria departizimin e bordeve të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve të tjera të pavarura.

21. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, mbështetur nga pesë deputetë nënshkrues, në lidhje me sigurinë e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se deputetja Teuta Haxhiu, mbështetur nga pesë deputetë nënshkrues, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me sigurinë e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë.

Ai e ftoi deputeten Teuta Haxhiu që si propozuese t'i paraqesë çështjet, për të cilat është kërkuar debati parlamentar.

Deputetja Teuta Haxhiu e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për debat parlamentar lidhur me sigurinë e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë. Diskutimi i plotë i deputetes Teuta Haxhiu është dhënë në transkript.

Për sigurinë e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë diskutuan deputetët: Valentina Bunjaku-Rexhepi, në emër të GP të LDK-së; Mexhide Mjaku-Topalli, në emër të GP të PDK-së; Ismajl Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP NISMA, Fidan Rekalii, Evgjeni Thaçi-Dragusha, Arbërie Nagavci, Flora Brovina, Drita Millaku, Nezir Çoçaj, Ganimete Musliu dhe Muharrem Nitaj, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe procedimi i votimit të rekomandimeve shtyhet.

Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me sigurinë e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë është bërë më 31 maj 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----70,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kuvendi me shumicë votash miratoi këto:

REKOMANDIME

1. Qeveria e Republikës së Kosovës obligohet të mbrojë secilin fëmijë nga përmbajtje të dhunshme dhe të dëmshme për zhvillim, duke siguruar që institucionet përgjegjëse të ofrojnë internet të sigurt për shkolla, duke përfshirë vendosjen e filtrave dhe kufizimeve në faqe që përmbajnë përmbajtje joadekuate për fëmijë.
2. MASHT, DKA, shkollat organizojnë aktivitete vetëdijesuese për prindër, mësimdhënës dhe nxënës për rreziqe që vijnë nga keqshfrytëzimi i internetit.
3. Të organizohen trajnime obliguese për zhvillimin e kapaciteteve të mësimdhënësve për përdorimin e TIK-ut në shkolla dhe mbrojtje nga rreziqet në internet.
4. Udhëzuesit për përdorim të sigurt të internetit të promovohen dhe mësimdhënësit të obligohen që t'i shfrytëzojnë si burime alternative gjatë procesit të mësimdhënies.
5. Hartimi i rregulloreve në nivel shkolle që të rregullojnë çështjen e përdorimit të internetit brenda hapësirave shkollore.
6. Shërbimet profesionale brenda shkollës të krijojnë mekanizma për të adresuar dhunën që buron nga keqshfrytëzimi i internetit, fuqizimi i ekipeve për ndërmjetësim mes bashkëmoshatarëve.
7. Plani zhvillimor i shkollës të plotësohet me masa dhe veprime konkrete për rritjen e sigurisë në shkollë, duke përfshirë masa konkrete për parandalimin e dhunës nga keqshfrytëzimi i internetit.
8. Të organizohen debate dhe programe edukative nëpër televizione nacionale dhe në media të tjera, me qëllim të vetëdijesimit të popullatës për përdorimin e drejtë të internetit.
9. Këshilli i prindërve dhe familjarëve nga ana e profesionistëve të punojnë me fëmijë për monitorim të fëmijëve gjatë përdorimit të internetit për të siguruar përdorim të drejtë të internetit nga fëmijët.
10. Të vetëdijesohen prindërit dhe t'i monitorojnë fëmijët që të mos përdorin informata të rrejshme për të hapur profilet e tyre si të rritur, pasi që shumica e kompanive të rrjeteve sociale e kanë të rregulluar çështjen e profileve për të rritur nën moshën 14-vjeçare, dhe
11. Të sanksionohet me ligj shantazhi i fëmijëve në rrjetet sociale dhe ruajtja e privatësisë së fëmijëve gjatë përdorimit të internetit.

Kryesuesi i ndërpreu punimet e kësaj seance plenare në orën 20:30.

* * *

E enjte, më 26 prill 2018

Vazhdimi i seancës plenare

Kryetari procedoi me pikat e papërfunduara të rendit të ditës, si në vijim:

22. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2018 ka kërkuar nga grupet parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie nga radhët e komunitetit shqiptar.

Ai tha se disa prej grupeve parlamentare i kanë propozuar deputetët për këtë komision, e disa jo.

Më pas, me propozimet e grupeve parlamentare, ai e hodhi në votim formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie.

Rezultati i votimit ishte:

Për-----78,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komunitetit shqiptar në këtë përbërje:

1. Rasim Selmanaj,nga GP i AAK-së, kryetar,
2. Armend Zemaj,.....nga GP i LDK-së, zv. kryetar i parë,
3. Jasmina Zhivkoviq.....nga GP i Listës serbe, zv. kryetare e dytë,
4. Fidan Rekalju,.....nga GP i LDK-së, anëtar,
5. Nezir Çoçaj,.....nga GP i PDK-së, anëtar,
6. Blerta Deliu-Kodra,.....nga GP i PDK-së, anëtare,
7. Valon Ramadani,nga GP i LVV-së, anëtar,
8. Adem Mikullovc,nga GP i LVV-së, anëtar,
9. Shqipe Pantina,nga GP Deputetët e Pavarur, anëtare,
10. Milaim Zeka,.....nga GP Nisma, anëtar dhe
11. Albert Kinolli,nga GP 6+, anëtar.

II. Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë nga radhët e komunitetit shqiptar të Komisionit të Pavarur të Mediave duhet të veprojë në përputhje me

nenin 11, paragrafi 2.2 i Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

* * *

23. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë.

Gjithashtu ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për interpelancë me kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë. Diskutimi i plotë i deputetit Glauk Konjufca është dhënë në transkript.

Kryesuesi e ftoi kryeministrin, z. Ramush Haradinaj, që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me këtë çështje.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Haradinaj, e paraqiti dhe e arsyetoi qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjet e ngritura në interpelancë. Diskutimi i plotë i kryeministrit Ramush Haradinaj është dhënë në transkript.

Lidhur me interpelancën e kryeministrit z. Haradinaj për reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë, diskutuan deputetët: Hykmete Bajrami, në emër të GP të LDK-së; Sala Berisha-Shala, në emër të GP të PDK-së; Albin Kurti, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Bekë Berisha, në emër të GP të AAK-së; Zafir Berisha, në emër të GP NISMA, Haxhi Avdyli, Arbërie Nagavci, Blerim Kuçi, Milaim Zeka, Salih Salihu dhe kryeministri Ramush Haradinaj, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Në fund të diskutimeve kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, propozoi për miratim rekomandimet lidhur me interpelancën e kryeministrit.

Pastaj, kryesuesi me propozim të kryetarit të GP të LVV-së, Glauk Konjufca, votimin e rekomandimeve e shtyu.

Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e kryeministrit në lidhje me reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë është bërë më 31 maj 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----48,
Kundër-----4,
Abstenime-----9.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto:

REKOMANDIME

1. Qeveria brenda 2 javëve, në bashkëpunim me menaxhmentin e KEK-ut, ta hartojë planin e masave për reagimin emergjent dhe afatgjatë në sigurimin e prodhimit të energjisë.
2. Zyra e Rregullatorit të Energjisë të mos pranojë kërkesa për rritjen e çmimit të energjisë nga kompania KEDS-KESCO.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës të iniciojë sa më shpejt rindërtimin e termocentralit “Kosova A”.
4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim me KEK-un të përshpejtojë planin e remontit të termocentralit “Kosova B”.
5. KOSTT-i të realizojë kontraktimin e energjisë elektrike me Shqipërinë për periudhë afatgjatë.
6. Qeveria të marrë masa urgjente dhe t’i aplikojë ato për stabilizimin e prodhimit të qymyrit si dhe sanimin e ndërtimeve të kundërligjshme në Shipitullë.
7. Të auditohet kontrata e privatizimit të distribucionit nga KEDS-i, e cila nuk është bërë kurrë.
8. ZRRE-ja ta kërkojë planin e mirëmbajtjes nga KEDS-i, në mënyrë që ta kontrollojë procesin e shkyçjeve që KESCO po i bën në emër të mirëmbajtjes.
9. ZRRE-ja t’i shqyrtojë reduktimet, çmimet e larta, tarifat për biznese që janë dukshëm më të larta, përdorimin e maksigrafit dhe kategorizimin në A+, që ndodhin dhe realizohen nga KEDS-KESCO.

Më pas, kryesuesi, në mungesë kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 19:45.

* * *

E enjte, më 31 maj 2018
Vazhdimi i seancës plenare

Kryetari procedoi me pikat e papërfunduara, si në vijim:

24. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 02/34, datë 5. 3. 2018, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion eurosh për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 02/34, datë 5. 3. 2018, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion eurosh për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës.

Gjithashtu ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputetja Mimoza Kusari-Lila, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për interpelancë me kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 02/34, datë 5.3.2018, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion eurosh për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës. Diskutimi i plotë i deputetes Mimoza Kusari-Lila është dhënë në transkript.

Kryesuesi e ftoi kryeministrin e Kosovës që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me këtë çështje.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e paraqiti dhe arsyetoi qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjet e ngritura në interpelancë. Diskutimi i plotë i kryeministrit Ramush Haradinaj është dhënë në transkript.

Lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 02/34, datë 5.3.2018, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion eurosh për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës diskutuan deputetët: Hykmete Bajrami, në emër të GP të LDK-së; Sala Berisha-Shala, në emër të GP të PDK-së; Albin Kurti, në emër të GP të LVV-së; Dardan Molliqaj, në emër të GP të PSD-së; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, Adem Mikullovc, Enver Hoti, Naser Rugova, Sami Kurteshi, Muharrem Nitaj, Milaim Zeka, Korab Sejdiu, Glauk Konjufca, Ahmet Isufi, Lumir Abdixhiku dhe kryeministri Ramush Haradinaj, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Në fund të diskutimeve deputetja Mimoza Kusari-Lila në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës i lexoi rekomandimet lidhur me interpelancën e kryeministrit.

Në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje nuk u procedua me votimin e rekomandimeve.

Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit në lidhje me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 02/34, datë 5.3.2018, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion eurosh për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës është bërë më 5 qershor 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----57,
Kundër-----16,
Abstenime-----0.

Kuvendi me propozim të GP-të LDK-së, e përfaqësuar nga deputetja Mimoza Kusari Lila, me shumicë votash e miratoi këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Obligohet Qeveria e Kosovës që afat prej tre muajsh të vijë me propozim për zgjidhjen e situatës së krijuar.
2. KOSST dhe ZRRE të përpilojnë planin e kompensimit të humbjeve të KOSST-it, të shkaktuara nga udhëzimi i ZRRE-së për furnizim të rrymës në komunat e veriut të Kosovës.
3. Qeveria e Kosovës nuk duhet të vazhdojë dialogun me Serbinë për çfarëdo çështje që ndërlidhet me energjinë, pa zbatimin e plotë të marrëveshjes ekzistuese.
4. Të krijohet një grup punues, i përbërë nga Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës, KOSST dhe ZRRE për të koordinuar veprimet për tejkalimin e situatës së krijuar.

25. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë “Contour Global” dhe Qeverisë së Kosovës për projektin e termocentralit “Kosova e Re”, të nënshkruar më 20 dhjetor 2017

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me nënshkrimin e marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë “Contour Global” dhe Qeverisë së Kosovës për projektin e termocentralit “Kosova e Re”, të nënshkruar më 20 dhjetor 2017.

Gjithashtu ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, Dardan Sejdiu, e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për interpelancë me kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me nënshkrimin e marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë “Contour Global” dhe Qeverisë së Kosovës për projektin e termocentralit “Kosova e Re”, të nënshkruar më 20 dhjetor 2017. Diskutimi i plotë i deputetit Dardan Sejdiu është dhënë në transkript.

Kryesuesi e ftoi kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me këtë çështje.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Haradinaj, e paraqiti dhe e arsyetoi qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjet e ngritura në interpelancë. Diskutimi i plotë i kryeministrit z. Haradinaj është dhënë në transkript.

Lidhur me nënshkrimin e marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë “Contour Global” dhe Qeverisë së Kosovës për projektin e termocentralit “Kosova e Re”, të nënshkruar më 20 dhjetor 2017, diskutuan deputetët: Lumir Abdixhiku, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Liburn Aliu, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP të PSD-së; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP NISMA, Haxhi Avdyli, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Ilir Deda dhe kryeministri Ramush Haradinaj, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Në fund të diskutimeve kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, Dardan Sejdiu i paraqiti rekomandimet lidhur me interpelancën e kryeministrit.

Në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje nuk është proceduar votimi i rekomandimeve të propozuara nga GP i PSD-së.

Votimi i rekomandimeve në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë “Contour Global” dhe Qeverisë së Kosovës për projektin e termocentralit “Kosova e Re” është bërë më 4 qershor 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----37,
Kundër ----- 50,
Abstenime----- 3.

Kuvendi nuk i miratoi rekomandimet në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë “Contour Global” dhe Qeverisë së Kosovës për projektin e termocentralit “Kosova e Re”, të propozuara nga Grupi Parlamentar i PSD-së.

Kryetari i ndërpreu punimet e kësaj seance në orën 18:20.

E premte, më 8 qershor 2018

Vazhdimi i seancës plenare

Kryesuesi procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

26. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputetja Fitore Pacolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për interpelancë me kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës. Diskutimi i plotë i deputetes Fitore Pacolli, është dhënë në transkript.

Kryesuesi e ftoi kryeministrin e Kosovës që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me këtë çështje.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, e paraqiti dhe arsyetoi qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjet e ngritura në interpelancë. Diskutimi i plotë i kryeministrit Ramush Haradinaj është dhënë në transkript.

Lidhur me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës diskutuan deputetët: Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Hajdar Beqa, në emër të GP të PDK-së; Fitore Pacolli, në emër të GP të LVV-së; Shqipe Pantina, në emër të GP të PSD-së; Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së; Enver Hoti, në emër të GP NISMA; Albert Kinolli, në emër të GP 6+, Korab Sejdiu, Nezir Çoçaj, Dardan Sejdiu, Albin Kurti, Blerim Kuçi, Milaim Zeka, Haxhi Avdyli, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Lirije Kajtazi, Xhelal Sveçla, Driton Çausi, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Rexhep Selimi, Zafir Berisha, Hykmete Bajrami, Arbërie Nagavci, Naser Rugova, Adem Mikullovc dhe kryeministri Ramush Haradinaj, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Në fund të diskutimeve deputetja Fitore Pacolli në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje i paraqiti rekomandimet lidhur me interpelancën e kryeministrit.

Në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, nuk është proceduar votimi i rekomandimeve.

Kryesuesi i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 14:30.

* * *

E enjte, më 28 qershor 2018

Vazhdimi i seancës plenare

Kryesuesi procedoi me votimin e propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës, e zhvilluar më 8 qershor 2018.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 23,
Kundër ----- 31,
Abstenime ----- 9.

Kuvendi nuk e miratoi propozim-rezolutën në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Grupi Parlamentar i LVV-së.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare më 28 qershor 2018, në orën 14:25.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale